



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:025140

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05449155

KA.nr.50/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësve 1) “Klan Kosova” ShPK me NUI 810795297 seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizerave, në Prishtinë, dhe 2) “ARTMOTION” Sh.P.K. me NUI 810200866 dhe seli në rrugën “Lidhja e Pejës” në Zonën Industriale në Prishtinë, kundër të paditurit “Komisioni i Pavarur i Mediave” me seli në Prishtinë, me objekt të konfliktit administrativ anulimi i aktit administrativ dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, jashtë seancës më 14 mars 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësve 1) “Klan Kosova” ShPK me NUI 810795297 dhe 2) “ARTMOTION” Sh.P.K. me NUI 810200866, kundër të paditurit “Komisioni i Pavarur i Mediave” me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të datës 21.12.2023 për miratimin e “Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale” të së paditurit, dhe kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të datës 21.12.2023, për miratimin e “Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale” të së paditurit.

A R S Y E T I M

Paditësit më 23.01.2024 në këtë gjykatë kanë paraqitur padi kundër të Paditurit, me të cilën kishin kërkuar anulimin e vendimit të datës 21.12.2023 për miratimin e “Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale” të nxjerr nga i Paditurit. Bashkë me padi kishin paraqitur edhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të sapo cekur.

Meqenëse Paditësit nuk kishin bashkëngjitur padisë vërtetimin mbi pagesën e taksës gjyqësore për padinë dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, gjykata më datë 24.01.2024 i ka dërguar Paditësve vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore, të cilën të dy paditësit e kanë pranuar më datë 01.02.2024. Përmes asaj vërejtjeje Paditësit ishin paralajmëruar se nëse nuk paguhet taksa gjyqësore brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit, atëherë gjykata do të veproj sipas nenit 253 para. 5 të LPK-së dhe nenit 5 lidhur me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor.

Në bazë të shkresave të lëndës gjykata konstaton se, Paditësit jo që nuk e kanë paguar taksën gjyqësore brenda afatit të caktuar prej 15 ditëve, por ajo nuk është paguar as deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi. Kjo gjykatë gjithashtu gjeti se në shkresat e lëndës nuk ka prova, në bazë të cilave do të mund të konstatohet se plotësohen kushtet ligjore nga nenet 468 deri 473 të LPK-së për lirim të Paditësit nga shpenzimet procedurale.

Pasojat juridike të mos pagesës së taksës gjyqësore janë të rregulluara në nenin 253 para. 5 të LPK-së, sipas të cilit *“Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*. Gjithashtu edhe neni 5 para. 5 nënpara 2 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësore ka përcaktuar se *“Pala duhet ta paguajë taksën në afatin e caktuar nga gjykatësi, gjegjësisht kryetari i trupit gjykues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 dite. Nëse kjo taksë nuk paguhet në kohën e caktuar, gjykata zbaton procedurat e parapara, si ne vijim: (...) 5.5.2 Nëse taksa për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas pranimit të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirim të palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253 paragrafi 5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr*.

Për këto arsye, gjykata e konsideron të tërhequr padinë e Paditësve dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.50/24

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.